

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Sea Front” SH.P.K**

Neni 1

**Emërtimi i shoqerise**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur “**Sea Front**” shpk e krijuar nga ortaku:

Sergan Çobaj shqiptar i datelindjes 27/09/1990 me mjet identifikimi J00927074W me pergjegjesi te plete e juridike per te vepruar  
Oltion Mehmeti shqiptar i datelindjes 30/04/1991 me mjet identifikimi J10430118T me pergjegjesi te plete e juridike per te vepruar

Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 „date 14.04.2008“ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Neni 2

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqërisë “**Sea Front**” shpk është Vlore, Lagjja Kushtrimi, Rruga Transballkanike, Kompleksi Çobaj Co90, Kati 1. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3

**Kohëzgjatja e veprimtarise**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do te jete subjekt i te drejtës me një afat te pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut te shoqerise.

Neni 4

## **Objekti**

Objekti i shoqërisë do te jete si vijon :

Aktivitet ne fushen e ndertimit: ndertime germime dheu me punime eventuale murature e beton arme, prishje dhe punime ne toke te germuar.Ndertime civile dhe ekonomike, rruge, hekurudha, ura vepra arti, ndertime detare, hidraulike, hidroteknike, vepra te vecanta e punime speciale, punime restaurimi, karpentierie, impiante teknologjike dhe te vecanta, punime sherbimi, punime te sinjalizimit rrugor.Proyektim, rikonstruksion vepra arti te vogla. Prodhime material ndertimi. Shitje blerje te objekteve te ndertuara dhe shperndarja e cdo lloj sherbimi me kliente e furniture te lidhur me shoqerine. Import eksport dhe shitjen e tyre me pakice dhe shumice te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, elektroshtepiake, materiale ndertimi, lende te para per ndertim, materiale inerte, bojra, materiale hidraulike, elektrike, lende drusore, pjese kembimi, makineri, konfeksione etj Blerje pjese kembimi per makina dhe makineri te ndryshme. Pastrime mirembajtjeje. Servis mjetesh. Blerje kancelerie, tonerash, detergjentesh. Punime sherbimi ne institucionet shteterore dhe private ku perfshiken, pastrime, recepcion, hedhje formular, riparime ne objekte zyra, furnizime hidrosanitare, elektrike, pajisje zyre mobileri, sherbime lyerje me boje dhe gelqere, blerje material druri, hekuri dhe nenprodukte te tij, vegla pune, sinjalistik, montim dhe çmontim skelash. Furnizime dhe tregtime lend djegese, nafta, pellet, gaz dhe nenprodukte druri dhe te tjera. Servise mjetesh motorrike shtetërore dhe te lëvizshme të të gjitha tonazheve( vetura, kamiona, ekskavatora, autobuza etj.) dhe pjeset perberese si goma, bateri, pjes motorrike xhenerike, hidraulike, vajra etj. Sherbime furnizimi ne fushen e kaldajave, ngrohje, ftohje, kondicionimit te ambjenteve. Punime trajtimi dhe sistemimi ne fushat e teknologjisë, bujqesisë, industriisë, infrastrukturës, mjedisit, telekomunikacion elektronik, hidroteknik, impjante mbeturinash, gjelbërimi, pyje, shëndetsi, hoteleri, turizëm, biznese te ndryshem. Ujësjellësa, gazësjelësa, kanalizime, dezinfektime, dezinsektimederatizim. Sherbim-Transporti. Guida turistike. Akomodim hoteleri.Punime speciale per dhoma izolimi spitale, burgje, spitale psiqiatrike etj. Arredim. Lavazho. Tregti energjie te riperteritshme dhe te pariperteritshme. Shit-blerje pasuri te luajtshme dhe te palujtshme. Shit-blerje mjetesh motorike dhe mjetet ujore.

## **NENI 5**

### **Kapitali i regjistruar**

Vlera e kapitalit te kontribuar dhe i regjistruar ne shoqëri ështe 300000. leke (treqindmije) , numri i kuotave eshte 2(dy)i ndare sipas kontributeve:

Oltion Mehmeti shqiptar i datelindjes 30/04/1991 me mjet identifikimi J10430118T me 1 kuote ne masen 50% ne vleren 150000 leke  
Sergan Çobaj shqiptar i datelindjes 27/09/1990 me mjet identifikimi J00927074W me 1 kuote ne masen 50% ne vleren 150000 leke

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te shoqerise .

#### Neni 6

##### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të shoqërise "Sea Front" shpk e të drejtat qerrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit nëkapitalin e shoqërisë;

shitblerjes;

trashëgimisë;

dhurimit

çdo mënyretjetër tëparashikuarme ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet meshkrim.

Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen ne mbledhjen e asamblese te shoqerise ku te drejten e parablerjes e kane ortaket e shoqerise

#### Neni 7

##### **Asambleja e Pergjithshme e shoqerise**

##### **Të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë përcështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

c) emërimin e shkarkimin i likuiduesvedhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendurnë shkronjat "c"

dhe "ç" tëkësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirëpërgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tëraporteve tëcurisë se veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tëraporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin etyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë nëgjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj

administratorëve;

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e irregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështjetë tjera të parashikuaranga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuaranë shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtijeni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës

3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishtepasur dijeni për të.

#### Neni 8

##### **Mbledhja e asamblesë së përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuaranga ky ligj, nga ligjetë tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshmee asamblesë së përgjithshme thirret tëpaktën një herënë vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton oseekziston rrëziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesëapo të disponojë në mënyrë jetë aktive, të cilat kanë njëvlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve tëpara pas regjistrimit të saj, propozon tëblejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtijeni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm/asambleja e ortakeve.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e

përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinëe administratorëve.

Neni 9  
**Mënyra e thirrjes**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi meshkresë ose, nëseparashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresëapo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditëpërpara datës së parashikuarpër mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime tëvlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, përtë marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10  
**Kërkesa nga ortakët e pakicës**

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnëtë paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuarnë statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrurasamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve tëposaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, përtë cilat asambleja duhet të marrë njëvendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtëta thërrasin asamblenë dhetë caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prejkëtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a) të ngrejëpadi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
  - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij nenidhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është idetyruar të deklarojë çdo fakt apo rrëthanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrëzikon të ndikojë në vendimmarrjen përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësua

### Neni 11

#### **Përfaqësiminë asamble**

1. Ortaku mund të përfaqësohen në asamblenë përgjithshme, në bazë të një autorizimingu një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët eshoqërisënu mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimimund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### Neni 12

#### **Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtëvotë, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosëpër çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 tëkëtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit totaltë votave janë të pranishëm personalisht, votojnë meshkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimevetëpikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendurnë pikën 1 tëkëtij neni, asambleja mblidhet përsërijo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### Neni 13

#### **Marrja e vendimeve**

1. Me përashtimtë rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tritë katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet nëpikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjene fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përashtimtë rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet etjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos meshumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Me përashtimtë rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrimet shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet

nga miratimi iortakut përkatës.

**Neni 14**  
**E drejta e votës**

1. Me përjashtimtë rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën enjë vote;
2. Statuti mund tëparashikojë përt ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë sëpërgjithshme memjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që tëgarantohet identifikimi ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesësë përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen përmblledhjen e asamblesë së përgjithshmenga një vendndodhje tjeter;
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përparrapo gjatë mbajtjes sëmbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, përtë marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, përt'u mundësuarortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme përtë garantiaridentifikimin e ortakëve dhe sigurinë ekomunikimeveelektronike, deri në atë masë që ky përdorimtë jetë proporcional me arritjen e këtyreqëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, qëu njihet nga ky ligj apo statuti, përtë marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

**Neni 15**  
**Përjashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim përt:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien osejo të përfitimiave të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson

Neni 16

### **Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbalevetë mbledhjetë asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përbajëdatën e vendin embledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit etë mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruehet nga kryetaridhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar njëfaqe në internet, administratorët, jo më vonëse 15 ditëngë data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit tëmbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 17

### **Drejtimi dhe administrimit**

Shoqeria tregtare “**Sea Front**” shpk do te drejtohet nga një administrator që emerohet me vendim te Asamblese te Shoqerise. Administratori i shoqerise per periudhen 5 vjecare duke filluar nga data e sotme do te jetë Sergan Cobaj shqiptar i datelindjes 27/09/1990 me mjet identifikimi J00927074W. Administratori ka te drejte e te detyrohet te :

- Kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politika tregtare te vendosur nga asamblea e përgjithshme e shoqerise.
- Perfaqesoje shoqerine tregtare
- Kujdeset per mbajtjen sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, paraqet keto perpara asamblea e përgjithshme e shoqerise per miratim,
- Krijon një system paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit
- Raporton para asamblese te përgjithshme e shoqerise ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me tendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
- Administratori do te shperblehet sipas percaktimit te asamblese se përgjithshme te shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjt nr 9901 date 14.04.2008.

Neni 18

**Kontrolli i brendshem**

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te regjistruar , i cil eshte perjegjes perpara shoqerise per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne regull e detyres se tij

Neni 19

**Bilanceet dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti, pavec rasteve e urdherave te vecanta te ottakeve te shoqerise.

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim.Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 Mars te viti pascardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdonim asamblese se përgjithshme te shoqerise.

Neni 20

**Shperberja e shoqerise**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe cfardo shkaku.Ne rast shkrirje para afatit te shoqerise, Asamblea e përgjithshme e shoqerise vendos mbi menyrat e likujdimit dhe caktton nje ose me shume likujdator duke i percaktuar dhe detyrat. Ne rasti e likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi "shoqeri ne likujdim "

Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit "

Neni 21

**Dispozitat perfundimtare**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut do i referohet plotesimeve nga asamblea e përgjithshme e shoqerise.

Shoqeria "Sea Front" shpk do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne per gjithesi ,normat e ketij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur .

Ky statut nenshkruehet nga ortaku i shoqerise ne daten 10/01/2024

Ortaket  
Oltion Mehmeti

Sergan Çobaj

Administrator

Sergan Çobaj